



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

DEÇANI



PËR/TO:	Z.Bashkim Ramosaj-Kryetar i Komunës së Deçanit
NGA/FROM	Znj.Agnesa Vokshi-Drejtoreshë për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

⇒ **PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2026**



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - synon të avancojë cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në komunën e Deçanit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, transparente dhe efikase.

Plani i punës për vitin 2026 fokusohet në modernizimin e infrastrukturës shëndetësore, përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët, si dhe fuqizimin e mekanizmave mbështetës për grupet në nevojë.

Ky plan ka për qëllim të sigurojë shërbime të barabarta dhe të pranueshme për të gjithë qytetarët, të rrisë përkushtimin ndaj pacientëve dhe komunitetit, dhe të nxisë avancimin profesional të stafit, duke kontribuar në një sistem shëndetësor dhe social më efektiv dhe modern.

➤ *Qëllimi i Planit*

Ky plan vjetor ka për qëllim organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2026, me fokus në:

- ✓ Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale;
- ✓ Sigurimin e qasjes së barabartë të qytetarëve në shërbimet shëndetësore dhe sociale;
- ✓ Avancimin profesional të stafit dhe modernizimin e infrastrukturës;
- ✓ Fuqizimin e mbrojtjes sociale të familjeve dhe qytetarëve në nevojë.

➤ *Objektivat kryesore*

- ✓ Sigurimi i shërbimeve shëndetësore primare dhe emergjente me cilësi.
- ✓ Përmirësimi i kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve në institucionet shëndetësore.
- ✓ Fuqizimi i mbrojtjes sociale për familjet dhe fëmijët në nevojë.
- ✓ Parandalimi i dhunës në familje dhe mbështetja e viktimave të saj.
- ✓ Përkrahja e integritetit social të personave të moshuar, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël.

➤ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA , 2026**

➤ **SHËNDETËSIA**

➤ **Renovim i Kulmit**

- ✓ Sanimi ose ndërrimi i mbulesës së kulmit
- ✓ Izolimi termik dhe hidroizolimi
- ✓ Përmirësimi i sistemit të kullimit të ujërave

Afati i realizimit:

Tremujori I – II, 2026

➤ **Furnizim me material mjekësor dhe barna**

Qëllimi:

Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore primare dhe emergjente.

Përfshin:

- ✓ Material shpenzues mjekësor
- ✓ Barna esenciale sipas listës zyrtare
- ✓ Pajisje ndihmëse për trajtime dhe ndërhyrje bazike

Afati i furnizimit:

Gjatë gjithë vitit 2026 (furnizime periodike / kontrata kornizë)

➤ **Furnizim me aparaturë laboratorike**

Qëllimi:

Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve laboratorike komunale.

Përfshin:

- ✓ Aparaturë biokimike
- ✓ Aparaturë hematologjike

- ✓ Aparaturë imunologjike
- ✓ Pajisje ndihmëse laboratorike

➤ *Furnizim me pajisje mjekësore*

Qëllimi:

Modernizimi i shërbimeve shëndetësore dhe rritja e kapaciteteve të QKMF-së dhe njësive tjera shëndetësore.

Përfshin:

- ✓ Pajisje mjekësore diagnostike
- ✓ Pajisje për trajtim dhe monitorim të pacientëve
- ✓ Pajisje ndihmëse për dhoma ekzaminimi

Afati:

Tremujori II – III, 2026

➤ *Furnizim me reagenca laboratorike (Biokimi dhe Hematologji)*

Qëllimi:

Mbështetja e diagnostikimit laboratorik dhe garantimi i analizave të sakta dhe në kohë.

Përfshin:

- ✓ Reagenca për analiza biokimike
- ✓ Reagenca për analiza hematologjike
- ✓ Material shpenzues laboratorik

Afati:

Tremujori I – IV, 2026

➤ *Furnizim me veshëmbathje për staf shëndetësor*

Qëllimi:

Standardizimi i paraqitjes profesionale dhe përmirësimi i kushteve të higjienës dhe sigurisë në punë.

Përfshin:

- ✓ Uniforma mjekësore për mjekë dhe infermierë
- ✓ Uniforma mbrojtëse

- ✓ Veshëmbathje pune për staf ndihmës

Afati:

Tremujori I, 2026

➤ **Realizimi i projektit të liftit të jashtëm në objektin e QKMF-së**

Qëllimi:

Përmirësimi i qasjes fizike për persona me nevoja të veçanta, të moshuar dhe pacientë, në përputhje me standardet e qasjes universale.

Përshkrimi i projektit:

- ✓ Hartimi i projektit teknik
- ✓ Ndërtimi i strukturës së jashtme mbajtëse
- ✓ Instalimi i liftit sipas standardeve të sigurisë
- ✓ Testimi dhe vënia në funksion

Afati i realizimit:

Tremujori II – III, 2026

➤ **Furnizim me inventar për institucionet shëndetësore**

Qëllimi:

Përmirësimi i kushteve të punës administrative dhe funksionale në objektet shëndetësore.

Përfshin:

- ✓ Mobilje për zyra dhe ambiente shërbimi
- ✓ Pajisje administrative
- ✓ Inventar teknik dhe ndihmës

Afati:

Tremujori I – II, 2026

➤ *Paisja me Mamograf*

Qëllimi:

Ofrimi i shërbimit shëndetsore për diagnostikim sa më të hershem për sëmundjet e gjirit.

Përfshinë :

- ✓ Trajnimi i stafit për realizimin e Mamografisë
- ✓ Adaptimi i dhomes për realizimin e Mamografisë–Izolimi ndaj rrezatimit.
- ✓ Paisjet teknike dhe administrative .

➤ *Fillimin e implementimit të planit për ndërhyrje në fëmijërinë e hershme*

Qëllimi:

Ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijet më ngecje në zhvillimin psikomotor.

Përfshinë:

- ✓ Rekrutimi i stafit : Logopedi, Fiziatr, Psikologu Klinik dhe Punëtori Social.
- ✓ Sigurimi i stafit të mesëm mbështetës si dhe trajnimi i tyre për punë me profesionistët në fjalë .
- ✓ Sigurimi i dhomave të punës
- ✓ Sigurimi i paisjeve teknike dhe administrative.

➤ *Vizitat sistematike orale*

Qëllimi:

Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve

Përfshinë:

- ✓ Organizimi i kontrolleve stomatologjike sistematike.
- ✓ Këshillimi për higjienë orale dhe orientimi për trajtim të mëtejshëm.
- ✓ Veçanërisht për fëmijët dhe grupet e ndjeshme.

➤ **Imunizimi i fëmijëve**

Qëllimi:

Mbrojtja e shëndetit të fëmijëve dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse.

Planifikohen të vaksinohen **1822 fëmijë**.

Përfshin:

- ✓ Zbatimi i vaksinimit sipas kalendarit shtetëror
- ✓ Evidentimi dhe ndjekja e fëmijëve të pavaksinuar
- ✓ Si dhe informimi i prindërve për rëndësinë e imunizimit.

Afati:

- ✓ Gjatë vitit 2026

➤ **Fushata vetëdijësuese**

Qëllimi:

Rritja e ndërgjegjësimit për shëndetin publik.

Përfshin:

- ✓ Organizimi i fushatave informuese për parandalimin e sëmundjeve.
- ✓ Promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës.
- ✓ Edukimin shëndetësor, në bashkëpunim me shkolla dhe institucione relevante.

Afati:

- ✓ Gjatë vitit 2026

➤ **MIRËQENIA SOCIALE**

- ✓ Evidentimi dhe monitorimi i familjeve në asistencë sociale, për të siguruar që mbështetja të arrijë tek ata që kanë nevojë reale.
- ✓ Identifikimi i familjeve ku fëmijët nuk ndjekin shkollimin, me qëllim të ndërhyrjes së hershme dhe përmirësimit të aksesit në arsim.
- ✓ Vizita të rregullta në shkolla për të vlerësuar nevojat e nxënësve dhe për të ofruar mbështetje sociale dhe këshilluese.
- ✓ Organizimi i fushatave dhe iniciativave kundër dhunës në familje, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të mbrojtur viktimat.
- ✓ Regjistrimi dhe përpunimi i rasteve të reja në bazë të shërbimeve sociale, dhe ndihmave sociale, për të siguruar mbikëqyrje dhe përgjigje efektive ndaj nevojave të komunitetit.
- ✓ Pjesëmarrja aktive në Mekanizmin Komunal kundër dhunës në familje, duke koordinuar veprimet ndërinstytucionale për mbrojtjen e viktimave.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes për fëmijët në situata të cenimit të drejtave të tyre, duke garantuar mirëqenie, zhvillim të shëndetshëm dhe integrim social.
- ✓ Takime dhe bashkëpunime të vazhdueshme me organizata joqeveritare për të përforcuar rrjetin e mbështetjes sociale në komunë.
- ✓ Organizimi i trajnimeve për stafin dhe aktorët socialë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe cilësisë së shërbimeve sociale.
- ✓ Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm social dhe integritit të individëve dhe familjeve nëkomunitet, duke nxitur një shoqëri më të barabartë dhe të përkujdesur për të gjithë.

➤ **Projekti për Banim Social**

Përfshin :

- ✓ Ndertimi i njësive të reja të banimit social
- ✓ Renovimi i shtëpive private për familjët dhe individët e cënueshëm
- ✓ Rindertimi i shtëpive private për familjës dhe individët e cënueshme.

Ky projekt është i paraparë që të implementohet në vitët në vijim.

➤ *Shtëpia e Komunitetit*

- ✓ Kryerja e analizave laboratorike për pacientët e vendosur në Shtëpinë e Komunitetit, çdo 6 muaj, për monitorim të rregullt të shëndetit.
- ✓ Organizimi i aktiviteteve për pacientët, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre dhe zhvillimin e aftësive për të rritur pavarësinë dhe mirëqenien.
- ✓ Furnizimi me terapi të përshtatshme sipas nevojave të pacientëve.
- ✓ Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet QKMF dhe SHK për sigurimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për pacientët e Shtëpisë së Komunitetit.
- ✓ Sigurimi i pranisë së *neuropsikiatrit* dhe *psikologut* për vlerësimin dhe trajtimin e pacientëve.
- ✓ Rinovime dhe përmirësime infrastrukturore në Shtëpinë e Komunitetit për të siguruar kushte të përshtatshme dhe të sigurta për banorët.
- ✓ Organizimi i aktiviteteve terapeutike për nxitjen e mirëqenies fizike dhe mendore të pacientëve.
- ✓ Bashkëpunimi me familjarët dhe kujdestarët e pacientëve për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe për të siguruar përkujdesje gjithëpërfshirëse.